



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR PROJEKTET NGA ARTI DHE KULTURA:

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të dhe rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, sipas thirrjes publike për Art dhe Kulturë për kategoritë si:

1. *Festivale, Muzikë, Manifestime, Kinematografi dhe Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë*

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

Për thirrjen publike për kategoritë: *Festivale, Muzikë, Manifestime, Kinematografi dhe Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë*

- Një përfaqësues/e nga OJQ-të, si dhe
- Një ekspert/e

Përfaqësuesi/ja e lartcekur që përzgjidhet do të jetë anëtar/e e komisionit vlerësues me të drejtë vote për vlerësimin e projekt-propozimeve komfor procedurave të rregullta administrative.

Aplikuesit duhet të jenë persona me përvojë profesionale mbi 3 vite në të paktën njërin nga fushat e lartpërmendura.

Afati për aplikim është nga data **02.04.2025** deri më datën **13.04.2025** si dhe kërkohet gjatë periudhës së aplikimit të dërgohet CV në postën elektronike zyrtare: kultura.pr@rks-gov.net